



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË**

OBJEKTIVAT FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË BIOLOGJI

Objektivat formuese të Programit të Studimi Bachelor në Biologji janë:

1. Përgatitja e Biologëve të rinj të aftë për drejtimin e procesit të mësimdhënies si dhe formimin e ekspertëve në fushën e kërkimit shkencor mjedisor.
2. Ngritja e kërkimit shkencor në nivelet bashkëkohore duke i shërbyer procesit të mësimdhënies si dhe ngritja e bazës së të dhënave që i shërbejnë kërkimit shkencor.
3. Sigurimi i përvojave arsimore e shkencore cilësore për studentët, në mënyrë që të aftësohen për të arritur një zhvillim të plotë intelektual, profesional e shoqëror.
4. Çdo student të arrijë me edukimin e tij një plotësim të kënaqshëm të vetvetes, në mënyrë që të japë kontribut të vlefshëm në profesionin e tij.
5. Të sigurohet një mjedis pozitiv i të nxënit si dhe një proces mësimdhënie rezultativ që evoluon vazhdimisht.
6. Mësimdhënia të jetë e mirëplanifikuar, në mënyrë që të lehtësojë procesin e të nxënit, si dhe të mundësojë shkëmbimet e ideve dhe bashkëpunimin e studentëve.
7. Stafit të përmirësohet vazhdimisht në funksion të programit, përmes zhvillimit të tij profesional, duke rritur aftësitë e tij mësimdhënëse e shkencore.
8. Stafit të përdorë mjete dhe strategji inovative që rrjedhin nga transferimi i teknologjisë për procesin e edukimit dhe kërkimit shkencor.
9. Të zhvillohet një kurrikul bashkëkohore në një mënyrë motivuese, progresive e stimuluese për të gjithë nivelet e studentëve.
10. Studentët të fitojnë një sërë njohurish praktike nëpërmjet përdorimit të laboratorëve si dhe punës me terrenin.
11. Studentët të përfitojnë njohuri mbi përpunimin e informacionit, shkrimin akademik si dhe aftësi të prezantimit të dijeve të tyre në publik.
12. Studentët të jenë të aftë të japin gjykimin e tyre për aspekte të prolematikave shkencore mjedisore.
13. Studentët të fitojnë njohuri, aftësi dhe shprehje profesionale me përmbylljen e ciklit të parë të studimit "Biologji", për t'u përballur me tregun aktual të punës në vend, si në institucionet publike dhe në ato jopublike.